



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 217, Datë 28.07.2026

MBI

MIRATIMIN E KALENDARIT TË VEPRIMIT PËR HARTIMIN DHE RISHIKIMIN E AKTEVE NËNLIGJORE NË ZBATIM TË LIGJIT NR. 59/2026 “PËR SEKTORIN E ENERGJISË ELEKTRIKE”

Në mbështetje të neneve 16 dhe 134, pika 4, të ligjit nr. 59/2026 *“Për Sektorin e Energjisë Elektrike”*, neneve 15 dhe 26, të *“Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”*, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 28.07.2026, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 2223 prot., datë 24.07.2026, të përgatitur nga Sekretari i Përgjithshëm *“Për miratimin e Kalendarit të Veprimit për hartimin dhe rishikimin e akteve nënligjore në zbatim të ligjit nr. 59/2026 “Për sektorin e energjisë elektrike”*,

Konstatoi se:

- Ligji nr. 59/2026, *“Për sektorin e energjisë elektrike”* i cili ka hyrë në fuqi më 15 korrik 2026 dhe ka shfuqizuar ligjin nr. 43/2015, *“Për sektorin e energjisë elektrike”*, të ndryshuar (neni 136, pika 1), përcakton një numër të konsiderueshëm kompetencash të reja për Entin Rregullator të Energjisë, të cilat kërkojnë hartimin e akteve të reja nënligjore dhe rishikimin e akteve ekzistuese.
- Sipas nenit 134, pika 4, të ligjit nr. 59/2026, ERE ngarkohet që, brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit, të miratojë 24 akte nënligjore, të identifikuar shprehimisht në këtë dispozitë, si dhe akte të tjera rregullatore pa afat të shprehur, sipas dispozitave përkatëse të ligjit.
- Për zbatimin efektiv të këtij ligji është e nevojshme planifikimi, koordinimi dhe monitorimi institucional i procesit të hartimit dhe miratimit të akteve rregullatore.
- Për këtë qëllim është hartuar Kalendar i Veprimit, në të cilin identifikohen aktet që duhet të miratohen ose rishikohen, baza ligjore, afatet përkatëse, strukturat përgjegjëse dhe procesi i konsultimit.
- Miratimi i këtij dokumenti përbën një instrument administrativ të domosdoshëm për organizimin dhe ndjekjen e procesit të implementimit të ligjit nr. 59/2026, *“Për Sektorin e energjisë elektrike”*.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të miratojë Planin dhe Kalendarin e Veprimit për hartimin, rishikimin dhe miratimin e akteve nënligjore dhe rregullatorë në zbatim të ligjit nr. 59/2026, “*Për sektorin e energjisë elektrike*”, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.
2. Strukturat organizative të Entit Rregullator të Energjisë sipas përfshirjes në grupet e punës të marrin masat për zbatimin e Kalendarit të Veprimit, në përputhje me përgjegjësitë dhe afatet e përcaktuara në të.
3. Çdo grup pune t'i paraqesë bordit, çdo muaj, një raport mbi ecurinë e zbatimit të Kalendarit të Veprimit, duke evidentuar aktet e miratuara, aktet në proces hartimi, vonesat eventuale dhe masat e propozuara për përmbushjen e afateve.
4. Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve, të njoftojë këtë vendim personelit teknik të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Petrit AHMETI

PLANI DHE KALENDARI I VEPRIMIT

PËR HARTIMIN, RISHIKIMIN DHE MIRATIMIN E AKTEVE NËNLIGJORE DHE RREGULLATORE NË ZBATIM TË LIGJIT NR. 59/2026 “PËR SEKTORIN E ENERGJISË ELEKTRIKE”

(Bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 217, date 28.7.2026)

I. QËLLIMI

Plani dhe Kalendari i Veprimit përcakton masat organizative, grupimin e akteve sipas fushave rregullatore, prioritetet, fazat dhe afatet për hartimin, rishikimin, konsultimin dhe paraqitjen për miratim të akteve nënligjore dhe rregullatore të nevojshme për zbatimin e ligjit nr. 59/2026 “Për sektorin e energjisë elektrike”.

Plani synon:

- a) përmbushjen brenda afateve ligjore të detyrimeve për nxjerrjen e akteve nënligjore dhe rregullatore;
 - b) harmonizimin e kuadrit rregullator ekzistues të ERE-s me dispozitat e ligjit nr. 59/2026;
 - c) shmangien e mbivendosjeve ndërmjet akteve që rregullojnë të njëjtën fushë ose procedurë;
 - ç) sigurimin e vijimësisë rregullatore gjatë periudhës së kalimit nga kuadri ekzistues në kuadrin e ri ligjor;
 - d) përcaktimin e një radhe pune dhe përgjegjësie të qartë për administratën e ERE-s;
- dh) sigurimin e konsultimit të projektakteve me operatorët, subjektet e rregulluara dhe palët e tjera të interesuara, kur kjo kërkohet nga legjislacioni në fuqi ose vlerësohet e nevojshme për shkak të natyrës së aktit.

II. PARIMET E ZBATIMIT TË PLANIT

1. Hartimi dhe rishikimi i akteve realizohet sipas fushave rregullatore të përcaktuara në këtë Plan, duke trajtuar në mënyrë të koordinuar aktet që kanë objekt, procedura ose efekte të ndërlidhura.

2. Për çdo fushë, procesi fillon me inventarizimin dhe analizën e akteve ekzistuese të ERE-s, me qëllim evidentimin e dispozitave që:

- a) mbeten të zbatueshme;
- b) duhet të ndryshohen ose plotësohen;
- c) duhet të zëvendësohen me akte të reja;
- ç) kërkojnë hartimin e një akti të ri për zbatimin e ligjit nr. 59/2026.

3. Kur disa dispozita të ligjit nr. 59/2026 rregullojnë elemente të së njëjtës procedurë ose fushë rregullatore, ato, për aq sa është e mundur dhe e përshtatshme nga pikëpamja e teknikës normative, trajtohen në një akt të vetëm.

4. Përparësi në hartim u jepet akteve:

- a) për të cilat ligji përcakton afat të shprehur;
- b) që janë të nevojshme për vijimësinë e procedurave administrative dhe rregullatore të ERE-s;
- c) që lidhen me veprimtari të reja të parashikuara nga ligji nr. 59/2026;
- ç) mungesa ose mospërshtatja e të cilave mund të krijojë paqartësi në ushtrimin e të drejtave dhe detyrimeve të subjekteve të rregulluara dhe klientëve.

III. ORGANIZIMI I PUNËS

ORGANIZIMI I PUNËS

1. Në zbatim të këtij Plani dhe Kalendarit, Kryetari i ERE-s, me urdhër, ngre grupet e punës sipas fushave dhe paketave të akteve të përcaktuara në Kreun IV.

2. Duke marrë në konsideratë rëndësinë e procesit të hartimit dhe rishikimit të kuadrit rregullator për zbatimin e ligjit nr. 59/2026 “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe nevojën për sigurimin e një qasjeje të koordinuar dhe koherente në ushtrimin e funksioneve rregullatore të ERE-s, secili grup pune drejtohet nga një anëtar i Bordit të ERE-s, i përcaktuar në urdhrin për ngritjen e grupit përkatës.

Drejtimi i grupit të punës nga një anëtar i Bordit synon të sigurojë orientimin dhe koordinimin e procesit të hartimit, respektimin e prioritetëve dhe afateve të përcaktuara në këtë Plan dhe Kalendar, si dhe trajtimin në mënyrë të harmonizuar të çështjeve që prekin më shumë se një fushë të veprimtarisë rregullatore.

Pjesëmarrja e anëtarit të Bordit në drejtimin e grupit të punës nuk cenon përgjegjësinë profesionale dhe administrative të strukturave të ERE-s për analizën, hartimin dhe argumentimin teknik, ekonomik dhe juridik të projektakteve dhe nuk paragjykon qëndrimin apo vendimmarrjen e Bordit gjatë shqyrtimit të tyre për miratim.

3. Përbërja e çdo grupi pune përcaktohet duke marrë në konsideratë natyrën e akteve që përfshihen në fushën përkatëse dhe nevojën për përfaqësimin e strukturave me përgjegjësi juridike, teknike, ekonomike, të tregut, licencimit, mbrojtjes së klientëve apo të fushave të tjera që lidhen me objektin e akteve.

4. Urdhrat për ngritjen e grupeve të punës nxirren brenda 10 (dhjetë) ditëve pune nga hyrja në fuqi e vendimit që miraton këtë Plan dhe Kalendar.

5. Në urdhrin përkatës përcaktohen, të paktën:

a) anëtarit i Bordit që drejton grupin e punës;

b) objekti dhe fusha e punës;

c) aktet që do të shqyrtohen, hartohen ose rishikohen;

ç) përbërja e grupit dhe strukturat e ERE-s të përfshira;

d) detyrat dhe produktet që duhet të përgatiten;

dh) afatet e ndërmjetme, në përputhje me afatet e përcaktuara në këtë Plan dhe Kalendar;

e) mënyra e koordinimit, raportimit dhe dokumentimit të punës.

6. Kryetari i grupit të punës organizon dhe koordinon veprimtarinë e grupit, përcakton ndarjen e detyrave ndërmjet anëtarëve, ndjek respektimin e afateve dhe siguron koordinimin me grupet e tjera të punës kur aktet ose çështjet në shqyrtim janë të ndërlidhura.

7. Kryetarët e grupeve të punës informojnë periodikisht Kryetarin e ERE-s mbi ecurinë e punës dhe respektimin e afateve. Në çdo rast kur evidentohet rrezik për mosrespektimin e një afati ligjor ose të një afati të përcaktuar në këtë Plan dhe Kalendar, kryetari i grupit të punës informon pa vonesë Kryetarin e ERE-s, duke evidentuar shkaqet dhe duke propozuar masat e nevojshme për përfundimin e procesit brenda afatit.

IV. FUSHAT DHE PAKETAT E AKTEVE

A. LICENCIMI, VEPRIMTARITË E RREGULLUARA DHE CERTIFIKIMI

Në këtë grup përfshihen, në veçanti:

1. Rregullorja për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave;
2. kushtet dhe kriteret për marrjen dhe ushtrimin e licencave, përfshirë afatin e vlefshmërisë, zonën e ushtrimit të veprimtarisë dhe kërkesat financiare, teknike, mjedisore dhe të sigurisë;
3. procedurat e thjeshtuara të licencimit, përfshirë procedurën e parashikuar për operatorët e impianteve të depozitimit të energjisë elektrike;
4. rregullorja për procedurat e transferimit të aseteve të të licencuarve;
5. aktet dhe kërkesat që lidhen me aplikimin dhe procedurat e certifikimit;
6. formatet, anekset dhe kushtet e licencave, për aq sa kërkohet përshtatja e tyre me ligjin nr. 59/2026;
7. çdo akt tjetër në fushën e licencimit, autorizimit ose certifikimit që, nga analiza e grupit të punës, rezulton i nevojshëm për zbatimin e ligjit.

Baza kryesore ligjore: nenet 20, 40, 41, 42, 46, 51 dhe 65 të ligjit nr. 59/2026.

Afati i synuar për përfundimin e paketës: jo më vonë se **prill 2027**, duke respektuar në çdo rast afatet specifike të përcaktuara nga ligji.

B. AKTET EKONOMIKE, TARIFORE DHE FINANCIARE

Në këtë grup përfshihen:

1. metodologjitë e tarifave që duhet të hartohen ose rishikohen në zbatim të ligjit nr. 59/2026;
2. sistemi i njësuar dhe standard i llogarive për të licencuarit;
3. akti për kushtet maksimale të çmimit për rishitjen dhe ndarjen e energjisë elektrike;
4. metodologjia/aktet për çmimet e rregulluara për kategoritë e klientëve për të cilët ligji parashikon rregullim;
5. aktet ekonomike që lidhen me balancimin, shërbimet ndihmëse dhe veprimtaritë e tjera të rregulluara;
6. çdo metodologji ose akt tjetër ekonomik dhe financiar që rezulton i nevojshëm nga analiza e legjislacionit dhe e akteve ekzistuese.

Baza kryesore ligjore: nenet 19, 40, 47, 93, 108 dhe dispozitat e tjera përkatëse të ligjit nr. 59/2026.

Afati i synuar për përfundimin e paketës: qershor 2027.

C. MBROJTJA E KLIENTËVE, FURNIZIMI DHE TREGU ME PAKICË

Në këtë grup përfshihen:

1. Kushtet e Përgjithshme të Shërbimit Universal të Furnizimit;
2. rregullat për Furnizuesin e Mundësisë së Fundit, përfshirë kriteret e vlerësimit dhe përzgjedhjes;
3. rregullat për ndryshimin e furnizuesit;
4. rregullorja për trajtimin e ankesave dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve;
5. kërkesat për informacionin minimal të faturimit dhe informacionin që u vihet në dispozicion klientëve;
6. kuadri rregullator për mjetin e krahasimit të ofertave;
7. aktet që lidhen me kontratat me çmim dinamik;
8. aktet që lidhen me klientët aktivë;
9. aktet që lidhen me komunitetet e energjisë, në përputhje me ligjin nr. 59/2026 dhe legjislacionin për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme;
10. çdo akt tjetër rregullator në kompetencë të ERE-s që rezulton i nevojshëm për reflektimin e të drejtave dhe detyrimeve të klientëve fundorë dhe pjesëmarrësve të rinj në treg.

Afati i synuar për përfundimin e paketës: Qershor 2027.

D. RRJETET, LIDHJET, CILËSIA, MATJA DHE PLANET E ZHVILLIMIT

Në këtë grup përfshihen:

1. rregullat e hollësishme për sigurinë e rrjetit dhe cilësinë e furnizimit;
2. rregullorja për procedurat e lidhjeve të reja në rrjetin e transmetimit dhe shpërndarjes;
3. metodologjia e kostove të lidhjes;
4. marrëveshja standarde e lidhjes;
5. rregullat për paraqitjen, shqyrtimin dhe miratimin e planit 10-vjeçar të zhvillimit të rrjetit të transmetimit;
6. rregullat për paraqitjen dhe miratimin e planeve të investimit/zhvillimit të rrjetit të shpërndarjes;
7. kërkesat minimale funksionale dhe teknike të sistemeve matëse inteligjente;
8. procedurat për paraqitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për verifikimin e saktësisë së matësit;
9. kontrata tip ndërmjet operatorit të sistemit dhe DPM-së ose subjektit të autorizuar për verifikimin e matësve;
10. metodologjia për vendosjen dhe përlllogaritjen e dëmit ekonomik të shkaktuar nga ndërhyrjet e paligjshme në sistemin e matjes;
11. aktet e tjera që lidhen me funksionimin, zhvillimin, mbikëqyrjen dhe performancën e sistemeve të transmetimit dhe shpërndarjes.

Baza kryesore ligjore: nenet 7, 30, 67, 79, 90, 93 dhe 94 të ligjit nr. 59/2026.

Afati i synuar për përfundimin e paketës: korrik 2027, pa cenuar afatin 12-mujor të zbatueshëm për aktet për të cilat ligji e parashikon shprehimisht.

E. TREGU, BALANCIMI, AGREGIMI DHE BASHKËPUNIMI RAJONAL

Në këtë grup përfshihen:

1. rregullat që mundësojnë funksionimin e një tregu të hapur, konkurrues, transparent dhe jodiskriminues;
2. rregullat e tregut të energjisë elektrike;
3. rregullat për tregun e ditës në avancë dhe tregun brenda së njëjtës ditë;
4. rregullat dhe aktet që lidhen me balancimin;
5. rregullat për menaxhimin e kapacitetit të kufizuar/kongestionit;

6. rregullat për pjesëmarrjen e OST-së në bashkëpunimin rajonal dhe funksionimin e strukturave rajonale përkatëse;
7. rregullat për kontratat e agregimin,
8. çdo akt tjetër që rezulton i nevojshëm për përshtatjen e kuadrit të tregut me ligjin nr. 59/2026 dhe detyrimet që rrjedhin nga integrimi rajonal dhe evropian i tregut.

Baza kryesore ligjore: nenet 8, 19, 63, 76, 99 dhe 122 të ligjit nr. 59/2026.

Afati i synuar për përfundimin e paketës: korrik 2027.

F. MASAT ADMINISTRATIVE DHE GJOBAT

Në këtë grup përfshihet:

1. rregullorja e posaçme për kushtet dhe procedurat e vendosjes dhe reduktimit të gjobave ndaj të licencuarve;
2. rishikimi i akteve dhe procedurave ekzistuese të ERE-s që lidhen me konstatimin e shkeljeve, zhvillimin e procedurës administrative dhe vendimmarrjen për masat administrative, për aq sa kërkohet harmonizimi i tyre me ligjin nr. 59/2026.

Baza kryesore ligjore: neni 133 i ligjit nr. 59/2026.

Afati i synuar për përfundimin: qershor 2027.

G. ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I ERE-S

Në këtë grup përfshihen:

1. Rregullorja për organizimin dhe funksionimin e ERE-s;
2. aktet e tjera të brendshme që, pas analizës, rezultojnë se duhet të harmonizohen me organizimin, kompetencat dhe procedurat e përcaktuara nga ligji nr. 59/2026.

Baza kryesore ligjore: neni 9, pika 2, i ligjit nr. 59/2026.

Afati i synuar për përfundimin: dhjetor 2026.

V. KALENDARI I PËRGJITHSHËM I ZBATIMIT

Nr.	Fusha / Paketa	Ngritja e grupit të punës	Analiza e akteve ekzistuese	Hartimi / rishikimi	Konsultimi	Finalizimi dhe paraqitja për miratim
1	Licencimi, veprimtaritë e rregulluara dhe certifikimi	Brenda 15 ditëve pune	Brenda 30 ditëve pune nga urdhri	Tetor 2026 – Janar 2027	Dhjetor 2026 – Shkurt 2027	Shkurt – Prill 2027
2	Aktet ekonomike, tarife dhe financiare	Brenda 15 ditëve pune	Brenda 30 ditëve pune nga urdhri	Nëntor 2026 – Mars 2027	Janar – Prill 2027	Mars – Qershor 2027
3	Klientët, furnizimi dhe tregu me pakicë	Brenda 15 ditëve pune	Brenda 30 ditëve pune nga urdhri	Nëntor 2026 – Mars 2027	Janar – Prill 2027	Mars – Korrik 2027
4	Rrjetet, lidhjet, cilësia, matja dhe zhvillimi	Brenda 15 ditëve pune	Brenda 30 ditëve pune nga urdhri	Dhjetor 2026 – Prill 2027	Shkurt – Maj 2027	Prill – Gusht 2027
5	Tregu, balancimi, agregimi dhe bashkëpunimi rajonal	Brenda 15 ditëve pune	Brenda 30 ditëve pune nga urdhri	Janar – Prill 2027	Mars – Qershor 2027	Maj – Gusht 2027
6	Masat administrative dhe gjobat	Brenda 15 ditëve pune	Brenda 30 ditëve pune nga urdhri	Janar – Mars 2027	Prill 2027	Maj – Qershor 2027
7	Organizimi dhe funksionimi i ERE-s	Brenda 15 ditëve pune	Shtator 2026	Tetor 2026	Nëntor 2026	Dhjetor 2026

VI. FAZAT E PUNËS PËR ÇDO AKT

Për çdo akt që hartohet ose rishikohet në zbatim të këtij Plani ndiqen, sipas natyrës së tij, këto faza:

Faza I – Analiza

- identifikimi i bazës ligjore;
- shqyrtimi i aktit ekzistues, kur ka të tillë;
- evidentimi i dispozitave që kërkojnë ndryshim;
- identifikimi i akteve të tjera të ERE-s që ndikohen nga ndryshimi;
- vlerësimi i legjislacionit të Bashkimit Evropian, acquis të Komunitetit të Energjisë dhe praktikave rregullatore relevante, kur janë të zbatueshme.

Faza II – Hartimi

Përgatitet projektakti dhe relacioni shpjegues, ku evidentohen të paktën baza ligjore, qëllimi, problematikat që adresohen, ndryshimet kryesore dhe ndikimi mbi kuadrin rregullator ekzistues.

Faza III – Konsultimi

Projektakti i nënshtrohet konsultimit publik dhe/ose konsultimit teknik me operatorët, subjektet e rregulluara dhe palët e interesuara, kur kjo kërkohet nga legjislacioni në fuqi ose vlerësohet e nevojshme për shkak të objektit dhe efekteve të aktit.

Faza IV – Finalizimi

Pas përfundimit të konsultimit shqyrtohen komentet dhe propozimet e paraqitura dhe përgatiten projekti përfundimtar, relacioni dhe dokumentacioni shoqërues për procedimin e mëtejshëm.

Faza V – Miratimi

Projektakti përfundimtar paraqitet për shqyrtim dhe vendimmarrje në Bordin e ERE-s, sipas procedurave të zbatueshme.

VII. MONITORIMI DHE RAPORTIMI

1. Drejtuesit e grupeve të punës raportojnë mbi ecurinë e punës, respektimin e afateve, problematikat e evidentuara dhe masat e nevojshme për përmbushjen e detyrave.

2. Për qëllime monitorimi mbahet një tabelë e përditësuar për çdo akt, me të paktën këta tregues:

- akti;
- baza ligjore;
- grupi i punës;
- faza e realizimit;
- afati;
- statusi;
- problematikat/pengesat;
- data e parashikuar për paraqitje për miratim.

3. Kryetarët e grupeve të punës informojnë periodikisht Kryetarin e ERE-s mbi ecurinë e punës dhe respektimin e afateve të përcaktuara në këtë Plan dhe Kalendar dhe në urdhrat përkatës. Në çdo rast kur evidentohet rrezik për mosrespektimin e një afati ligjor ose të një afati të përcaktuar në këtë Plan, kryetari i grupit të punës informon pa vonesë Kryetarin e ERE-s, duke evidentuar shkaqet dhe duke propozuar masat e nevojshme për përfundimin e procesit brenda afatit.

5. Në rast se gjatë zbatimit të Planit evidentohen akte të tjera që kërkojnë hartim ose rishikim, ato përfshihen në fushën përkatëse dhe procedohen në përputhje me afatet ligjore dhe prioritetet e përcaktuara në këtë Plan.

6. Afatet e përcaktuara në këtë Plan janë afate të brendshme organizative dhe nuk mund të interpretohen ose zbatohen në mënyrë që të tejkalojnë një afat detyrues të përcaktuar nga ligji nr. 59/2026 ose nga legjislacioni tjetër në fuqi.

VIII. DISPOZITA PËR ZBATIMIN

1. Urdhrat për ngritjen e grupeve të punës nxirren pas miratimit të këtij Plani dhe Kalendarit dhe duhet të jenë në përputhje me grupimin, prioritetet dhe afatet e përcaktuara në të.

2. Në rast se një akt përfshin çështje që i përkasin më shumë se një fushe, grupet e punës bashkëpunojnë ndërmjet tyre, ndërsa përgjegjësia koordinuese përcaktohet në urdhrin përkatës të Kryetarit.

3. Grupimi i akteve në këtë Plan ka karakter organizativ dhe nuk paragjykon formën përfundimtare të aktit. Gjatë procesit të hartimit mund të propozohet bashkimi, ndarja ose sistemimi në një akt të vetëm i disa çështjeve rregullatore, kur kjo siguron koherencë më të mirë normative dhe shmang mbivendosjen e dispozitave.

4. Aktet rregullatore ekzistuese vijojnë të zbatohen për aq sa nuk bien në kundërshtim me ligjin nr. 59/2026 dhe legjislacionin tjetër në fuqi, daljen e akteve të reja sipas procedurave përkatëse.

5. Për aktet për të cilat ligji nr. 59/2026 apo legjislacioni në fuqi përcakton afat të posaçëm për miratim, afati ligjor prevalon ndaj çdo afati të ndërmjetëm të përcaktuar në këtë Plan.

6. Ky Plan dhe Kalendar përbën bazën programore për nxjerrjen e urdhrave të Kryetarit për ngritjen dhe funksionimin e grupeve të punës dhe për monitorimin e procesit të hartimit dhe rishikimit të kuadrit rregullator në zbatim të ligjit nr. 59/2026.